



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Mars 2022

Nr: 124

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin e shkeljeve të konstatuara nga raportimi i monitorimit, për moszbatim të vendimit nr. 105 datë 28 Shkurt 2022 dhe 106 e 107 datë 1 Mars 2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Policisë Bashkiake Shkodër

Ndaj: Policisë Bashkiake Shkodër

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, pika 2, dhe 79 pika 1, 92, 171 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata

VËREN:

I

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur nga ana e monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, të datës 6 Mars 2022, për bashkinë Shkodër raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore si vijon:

- 1- Për **subjektin zgjedhor Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” janë paraqitur 2 (dy) raporte** “Raport mbi shkeljet e vërejtura” me nr. 1159 prot., datë 23.02.2022 dhe “Raport mbi shkeljet e vërejtura”



Data: 4 Mars 2022

Nr. 124

“Për shqyrtimin e shkeljeve të konstatuara nga raportimi i monitorimit, për moszbatim të vendimit nr. 105 datë 28 Shkurt 2022 dhe 106 e 107 datë 1 Mars 2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Policisë Bashkiake Shkodër

me nr. 1308 prot., datë 01.03.2022, ku është konstatuar vendosja e materialeve propagandistike për këtë subjekt, në kundërshtim me udhëzimin nr. 6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 105, datë 28 Shkurt 2022, “Për konstatim të shkeljes së parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.

- 2- Për **subjektin zgjedhor “Partia Demokratike” janë paraqitur 3 (tre) raporte**, “Raporti mbi shkeljen e vërejtur” nr. 1159 prot., datë 23.02.2022 dhe “Raporti mbi shkeljen e vërejtur” nr. 1286 prot., datë 28.02.2022 dhe “Raporti mbi shkeljen e vërejtur” nr. 1309 prot., datë 01.03.2022, ku është konstatuar vendosja e materialeve propagandistike për këtë subjekt, në kundërshtim me udhëzimin nr. 6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 106, datë 01.03.2022 “Për konstatim të shkeljes së parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”.
- 3- Për **subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” është paraqitur 1 (një) raport**, “Raport mbi shkeljet e vërejtura” nr. 1310 prot., datë 01.03.2022, ku është konstatuar vendosja e materialeve propagandistike për këtë subjekt, në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 107, datë 01.03.2022 “Për konstatim të shkeljes së parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në të 3 (tre) këto vendime ka vendosur që Policia Bashkiake Shkodër, të marrë **masa të menjëhershme për heqjen e materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore të mësipërme.**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë paraqitur “Raportit për shkeljet e vërejtura” nr. 1534 prot., datë 04.03.2022 dhe “Raportit për vërejtjen e shkeljes” nr. 1536 prot., datë 04.03.2022, nëpërmjet të cilave konfirmohet se Policia Bashkiake Shkodër, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor duke mos marrë masa të menjëhershme për zbatimin e vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.



Vlerësimi i kompetencës:

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga monitoruesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon, të vijojë procedurën administrative ndaj Policisë Bashkiake Shkodër, ndaj të cilës atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

II.

Analiza ligjore

Referuar nenit 79, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar përcaktohet se: **“Policia Bashkiake dhe/ose Policia e Shtetit garantojnë zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë nen duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore në vendet jashtë përcaktimeve të bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni”**.

Referuar “Raport mbi shkeljet e vërejtura” nr. 1534 prot., datë 04.03.2022, ora 11:30 AM dhe “Raport mbi shkeljet e vërejtura” nr. 1536 prot., datë 04.03.2022, ora 14:00 AM, është konstatuar se Policia Bashkiake Shkodër, pavarësisht marrjes dijëni, nuk ka marrë asnjë masë për heqjen e materialeve

propagandistike për subjektet zgjedhore Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, “Partia Demokratike” dhe “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, vlerëson se nga ana e Policisë Bashkiake Shkodër, nuk janë marrë masa për heqjen e materialeve propagandistike.

Referuar raporteve të monitoruesve të KQZ-së të datës 4 Mars 2022, konstatohet se Policia bashkiake Shkodër, pavarësisht marrjes dijani, nuk ka marrë asnjë masë për heqjen e materialeve propagandistike për subjektet zgjedhore Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, “Partia Demokratike” dhe “Partia Socialiste e Shqipërisë” në këto vendndodhje: në fasada në rrugën “Xhabie”, afër QV-së së shkollës “Jordan Misja”, afër QV-së së shkollës “Oso Kuka”, në rrugën “Jeronim De Rada”, piaca “Truma”, në rrugën “Agron Zhyreku dhe në godinën e fabrikës së maskave, Shkodër.

Mospërmbushja e detyrimit nga Policia Bashkiake, Shkodër, përbën shkelje të nenit 79, pika 5, e Kodit Zgjedhor dhe ndëshkohet sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. i cili parashikon se, *“shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”*.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” e “n”, pika 2, dhe nenet 79 pika 1, 92, 171 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

- 1- Sanksionin administrativ me gjobë ndaj Policisë Bashkiake Shkodër, në masën 50. 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- 2- Ky vendim përbën titull ekzekutiv.



- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 4- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Iirjan CELIBASHI



Data: 4 Mars 2021

Nr. 124

“Për shqyrtimin e shkeljeve të konstatuara nga raportimi i monitorimit, për moszbatim të vendimit nr. 105 datë 28 Shkurt 2022 dhe 106 e 107 datë 1 Mars 2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Policisë Bashkiake Shkodër”